



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

**KEC**

**Kodi: 028**

## **EDUKIMI, THEMELIMI DHE MONITORIMI I STRUKTURAVE QË LUFTOJNË KORRUPSIONIN**

### Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të identifikojnë format e ndryshme të paraqitjes së korrupsionit në shoqëri, si dhe shkaqet dhe pasojat që shkakton ai.
- Të promovojë strategjitë për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.
- Të shpërndajnë informacion në vendin e tyre të punës për të sensibilizuar kolegët që të mos bien pre e dukurive korruptive.
- Të kontribuojnë në vetëdijësimin e qytetarëve për rrezikun që shkakton korrupsioni në pengimin e zhvillimit të shoqërive demokratike.
- Të inkurajojnë bashkëpunimin e qytetarëve me strukturat e ndryshme, të cilat e parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin.
- Të bëhen burim përvoja dhe njohurish për qytetarët e tjerë
- Të inicojnë projekte, të cilat do t'i kontribuonin parandalimit dhe luftimit të korrupsionit.

### Përmbajtja

Përkufizimi dhe format e paraqitjes së korrupsionit. Referenca nga Kodi i përkohshëm penal i Kosovës. Korrupsioni politik dhe administrativ. Shkaqet dhe pasojat e paraqitjes së tij. Indeksi i perceptimit të korrupsionit (CPI). Llogaritja e CPI. Indeksi i paguesve të mitos (BPI) dhe Barometri i korrupsionit global (GCB). Rezultatet e disa hulumtimeve të shkallës së korrupsionit në Kosovë (MIS, RIINVEST, UNDP etj.). Luftimi i paragjykimëve. Strategjitë për luftimin e korrupsionit. Edukimi – strategjia më efektive për parandalimin e korrupsionit. Strategjia kundër Korrupsionit. Masat e parapara në Strategjinë kundër korrupsionit. Plani i veprimit kundër korrupsionit në Kosovë. Ligji

kundër korrupsionit. Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencionit kosovar kundër korrupsionit. Roli i institucioneve, mediave dhe OJQ-ve në luftimin e korrupsionit.

### Grupi i synuar

Nga ky program mund të përfitojnë zyrtarë të institucioneve qendrore dhe lokale, anëtarë të OJQ-ve, përfaqësues të mediave dhe bizneseve private, administratorët e shkollave, hartuesit e kurrikulave dhe të teksteve shkollore, zyrtarët e arsimit, mësimdhënësit, si dhe të gjithë qytetarët, të cilët synojnë të kontribuojnë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

### Forma e organizimit/ Kohëzgjatja

Programi organizohet në formë të seminarit 2-ditorë dhe përmban 16 orë trajnim.

### Certifikimi

Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminarit.